Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY
Nr/Br. 324/19
Data/Datum. 04.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 324 / 19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina– Kryetar, z, Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Sigal Uniqa Group Austria" kundër njoftimit për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: "Shërbimet e sigurimit të automjeteve të PK-së", me numër të prokurimit: 214-19-1219-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës. më datën 26.06.2019 mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Sigal Uniqa Group Austria" kundër njoftimit për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e sigurimit të automjeteve të PK-së", me numër të prokurimit: 214-19-1219-2-1-1iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK - "Policia e Kosovës"

II.ANULOHET, vendimi për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e sigurimit të automjeteve të PK-së", me numër të prokurimit: 214-19-1219-2-1-1 AK- "Policia e Kosovës" dhe lënda kthehet ne **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Sigal Uniqa Group Austria" aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 29.03.2019
Data e hapja së ofertave: 08.05.2019
Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit te pasuksesshëm: 07.06.2019
Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës: 07.06.2019

Kundër njoftimit te autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik "Sigal Uniqa Group Austria" me dt: 11.06.2019, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.
Autoriteti Kontraktues - "Policia e Kosovës" me datën 11.06.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: "Sigal Uniqa Group Austria" si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues "Sigal Uniqa Group Austria" si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.06.2019 me nr. 324 / 19, kundër vendimit te AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e sigurimit të automjeteve të PK-së", me numër të prokurimit: 214-19-1219-2-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - "Policia e Kosovës" duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6,7,59 ,si dhe neni 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 22.06.2019, lidhur me pretendimin ankimore te OE

ankues "Sigal Uniqa Group Austria" në finalizim te analizimit dhe shqyrtimit te këtij aktiviteti te prokurimit, konstaton si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se nuk e ka plotësuar kërkesën lidhur me kontratat dhe referencat, konkretisht komisioni vlerësues pasi qe ka pasur paqartësi ne lidhje me disa referenca, se a janë kontratat aktive për disa referenca. Përgjigje e OE për sqarimet e kërkuara ka specifiku se kontratat janë aktive dhe kjo është sipas kriterit te kërkuar ne dosje te tenderit bazuar ne LPP, RrUOPP dhe te pyetjet e shpeshta ne ueb faqen e KRPP-se, përgjigja nr. 57, gjithashtu referencat tjera nuk i plotësojnë kriterin e kërkuar ne dosje te tenderit për realizimin e kontratave për tri vitet e fundit ne vlere minimum 300,000.00€.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyen e eliminimit te OE ankues sqaron se AK-ja, ka gjate vlerësimit te ofertës se OE ankues i ka vërejtur disa paqartësi ne listën e kontratave dhe referencave lidhur me periudhat kohore për te cilat është lëshuar referenca, për vlerat e referencave dhe periudhat e realizimit dhe një herit eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne oferte e tij e ka dorëzuar listën e kontratave dhe referencat.

AK-Policia e Kosovës me datën 23.05.2019, lidhur me paqartësitë e lartpërmendura ka kërkuar sqarim nga OE ankues, konkretisht ka kërkuar sqarim për kontratën me nr. rendor 1, 2, 3 dhe 8 te listës se kontratave.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues pas pranimit te kërkesës se AK-se, për sqarim me datën: 27.05.2019 kthen përgjigje sipas kërkesës se AK-se duke ja bashkangjitur edhe kontratat për referencat e dorëzuar.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ne përgjigje te kërkesës se AK-se i ka dorëzuar këto kontrata:

1. Kontratë e lidhur me KEDS, me nr: 25/2016, vlera: 59,000.00€.
2. Kontratë e lidhur me KEDS, me nr: 381/2018, vlera: 51,750.00€.
3. Kontratë e lidhur me KEDS, me nr: 107/2016, vlera: 60,000.00€.
4. Kontratë e lidhur me KEDS, me nr: 208/2017, vlera: 60,000.00€.
5. Kontratë e lidhur me KEDS, me nr: 456/2018, vlera: 69,879.00€.

Vlera totale e kontratave arrin ne 300,629.00€ dhe për te gjitha kontratat e lartpërmendura gjendet edhe referenca e lëshuar nga KEDS.

Vlen te përmendet fakti qe ne te njëjtën referencë është e shënuar edhe një kontratë me nr: 192/2018 me vlerë 59,000.00€ por qe nuk ka bashkangjitur kontratë me nr. 192/2018.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ka dorëzuar edhe referenca tjera:

1. Referencë te lëshuar nga AK-MPMS, e lidhur me datë: 23.02.2016-24.02.2018, vlera: 33,600.65€.
2. Referencë te lëshuar nga AK-Trafiku Urban, e lidhur ne vitin 2018, vlera: 35,057.80€.
3. Referencë te lëshuar nga AK-Komuna Prishtinë, për periudhën 2016, 2017 dhe 2018, vlera: 58,614.32€.

Vlera totale e Referencave te lartpërmendura arrin ne 127,272.77€.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne oferte ne tij OE ankues i ka dorëzuar edhe disa referenca te cilat kanë kontradikta ne mes te referencës dhe kontratës siç është rasti te referenca dhe kontrata me Raiffeisen Bank, pastaj ka referencë projekti i te cilës nuk ka përfunduar dhe nuk mund te merret parasysh një kontratë e papërfunduar.

Eksperti shqyrtues, ne fund te analizimit dhe shqyrtimit te arsyes se eliminimit, sqaron se AK-ja, ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-se e ka eliminuar për faktin se OE ankues ne sqarimin e datës: 27.05.2019, i ka ofruar kontratat me te cilat ka dëshmuar se e arrin vlerën e kërkuar sipas kërkesës se dosjes se tenderit ne vlerën prej: 300,000.00€.

Prandaj, ne bazë te dëshmive te ofruara eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues vetëm me kontratat dhe referencat e lartshënuara arrin vlerën prej: 427,901.77€.

Vlen te përmendet fakti se OE ankues ne përgjigje te kërkesës se AK-se për sqarim i ka dorëzuar edhe disa raporte te polisave te sigurimit me Raiffaisen Bank dhe me Kuvendin e Kosovës ne vlerë prej: 222,288.18€.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 21.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 21.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i OE- ankues z. Shkodra deklaroj: Ne e kemi konfirmuar se pajtohemi pjesërisht, ndërsa për 2 pika qe nuk jemi pajtuar kemi sjell dëshmi, ne ankese i kemi bashkëngjit edhe kontratën me këto dy institucione ne veçanti me Raiffaisen Lising kontrata është ne vlefshmëri 1 vjeçare ndërsa sipas nenit 12 është kontrate e ripërtërishme për çdo vite nëse palët nuk kane për te shtuar apo amandamentuar diçka, nëse nuk ka diçka kontrata vazhdohet ne heshtje, andaj është e pakuptimtë te hedhet poshtë një reference me vlere kaq te madhe me arsyetimin qe kontrata është valide dhe nuk mund te merret si reference e rregullt. Ne i kemi prezantuar 2 referenca te lëshuar nga Raiffeisen te datës 22.11.2017 për periudhat e sigurimit 2014, 2015,2016 qe ne fakt këtu merret vetëm qarkullimi i 2016 dhe referenca dt 19.02.2019 qe mbulon periudhat 2017 dhe 2018. Nëse Autoriteti Kontraktues ka menduar qe janë kontrata jo valide është dashtë ti konfirmoj ato nga autoritetet e lëshuar. Po edhe si te jetë prapë ashtu ne e kemi kaluar me referenca kërkesën e Autoriteti Kontraktues. Për dëshmi i dorëzoj panelit raportin e policave te shitura.
Përfaqësuesi i OE ankues z. Shkodra tha qe sot do ti dërgoj ne e-mail te OSHP-se panelit shqyrtues një vërtetim te ATK-se.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i AK-së z. Cufaj i cili deklaroj: Ne si Autoriteti Kontraktues nuk jemi pajtuar me mendimin ekspertit për shume arsye e sidomos me kontratat e KECIt dhe te trafikut urban dhe KK-Prishtinës, si kërkesë ne DT ka qene OE duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar realizuar kontrata për 3 vitet e fundit 2016, 2017, 2018 ne vlere minimum 300.000 euro ne ekspertizën e ekspertit kontratat me KEC me nr 456 është ende ne fuqi e lidhur me datën 12.11.2018 kontrate kornize një vjeçare kjo bjen qe kontrata me mundësi vazhdimi nuk ka përfunduar. Është edhe Kontrata 381/2018 e nënshkruar me 01.05.2018 kontrate kornize për 1 vit me mundësi vazhdimi, është një aneks kontrate por nuk ka vlere me datën 28.08.2017 por kontrata nuk ka vlere. Kontrata me Trafikun Urban është kontrate për 12 muaj me date 12.02.2018 dhe ka përfunduar me date 11.02.2019 e kemi edhe një kontrate me KK-PRISHTINE me date 30.01.2017 është kontrate për 36 muaj deri ne vitin 2020 është ne fuqi, ne baze te këtyre OE nuk e plotëson vlerën siç është kërkuar minimum 300.000 euro.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Basha deklaroj:Sa i përket kontratës me Raiffeisen kjo kontrate ka kontradit për shkak vlerës ne kontrate dhe reference. Se dyti ne lidhje me kontratat e KECIT kontratat i njëjti i ka dorëzuar brenda viteve te kërkuara nga Autoriteti Kontraktues me vlerën e mbulon kërkesën e Autoriteti Kontraktues prej 300.000 pavarësisht pretendimit te përfaqësuesit te Autoriteti Kontraktues se këto kontrata janë ne fuqi OE Ankues për te njëjtat kontrata ka dorëzuar referenca.

Kryetari i panelit në vazhdim fjalën ia dha përfaqësueses së OE-së rekomanduar për kontrate znj. Jani e cila deklaroj: Ajo çka është shqetësuese nga ana jone është qe te merren për bazë vërtetimi i ATK-se për OE Ankues, OE ankues ka borxhe, OE ankues është eliminuar nga MTI. Kërkojmë te mbetet ne fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë qe te aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Kërkoj te refuzohet ankesa e OE-se si e pabazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, vlerëson se kontratat dhe referencat e dorëzuara nga OE ankues, kanë paqartësi lidhur me vlerat dhe vitet për te cilat i ka përfunduar projektet.

Andaj, paneli shqyrtues, e obligon AK-se, qe gjatë rivlerësimit të ofertave konform nenit 72 të LPP-se, ti verifikoj saktë dhe në mënyrë të detajuar të gjitha vlerat e ofruara në kontrata për secilin vitë veç e veç në mënyrë që të konstatoj saktë vlerën e punëve te përfunduara.

Prandaj, paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Po ashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit duhet te këtë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase,

më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim Dina

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Policia e Kosovës"

1x1 OE- "Sigal Uniqa Group Austria"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.